

Statuti i Lëvizjes për Drejtësi

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Lëvizja për Drejtësi e Kosovës është parti politike e profilizuar si parti e qendrës së djathtë. Është e hapur për anëtarësimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, e organizuar me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe orientimeve programore.

Neni 2.

Emërtimi i partisë është: **Lëvizja për Drejtësi**

Akronimi i Lëvizjes për Drejtësi është: **LD**

LD e ka emblemën me përmbajtje (të bashkangjitur e keni në shtojcë).

Neni 3.

Lëvizja për Drejtësi ka shtrirje dhe vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4.

Në kuadër të partisë Lëvizja për Drejtësi veprojnë:

- Vizioni i Gruas
- Vizioni Rinor

Neni 5.

Lëvizja për Drejtësi e ka cilësinë e personit juridik.

Neni 6.

Partia përfaqësohet nga kryetari i Partisë. Në mungesë të kryetarit, atë e përfaqëson Sekretari i Përgjithshëm i LD-së apo njëri nga nënkryetarët e Partisë, me vendimin e kryetarit të Partisë.

Neni 7.

Qëllimi i LD-së është ardhja në pushtet dhe realizimi i orientimeve programore dhe platformës politike, nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Neni 8.

Lëvizja për Drejtësi, me qëllim të realizimit të orientimeve të saja programore, do të bashkëpunoj me parti dhe organizata simotra në vend dhe jashtë vendit.

Po me këtë qëllim, Partia mund të bashkohet me një ose më shumë parti.

Vendimi për këtë aprovohet nga Këshilli Drejtues i Partisë.

Neni 9.

Aktivitetet e forumeve dhe strukturave të partisë janë publike dhe transparente .

Informimi i aktiviteteve është i vazhdueshëm dhe realizohet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe të shkruara të informimit.

Partia me qëllim të informimit të gjerë mund të formoj edhe organet e veta informative.

II Anëtarësia

Neni 10.

Në Lëvizja për Drejtësi kanë të drejtë anëtarësimi çdo qytetar i interesuar i cili pranon Programin dhe Statutin e Partisë.

Neni 11.

Anëtarësimi bëhet në mënyrë të lirë dhe vullnetare.

Anëtarësimi realizohet në nëndegë, ku aplikuesi ka vendbanimin ose në vendin ku ushtron veprimtarinë e përhershëm. Njëkohësisht anëtarësimi mund të realizohet edhe përmes aplikimit elektronik.

Anëtari i anëtarësuar pajiset me librezë dhe evidentohet në regjistrin unik të Partisë.

Neni 12.

Anëtarësimi në LD pushon në këto raste:

- largimi nga Partia me vetdëshirë,
- përjashtimi nga Partia për arsye të aktiviteteve kundër Statutit dhe Programit të Partisë dhe kundër vendimeve të kryesisë së Partisë,
- me kandidimin në zgjedhje pa pëlqimin e Partisë,
- me anëtarësim në një parti tjetër,

Neni 13.

Me largim ose përjashtim nga partia, anëtari privohet nga çdo e drejtë në Parti.

Anëtari i përjashtuar duhet të dorëzoj librezën e anëtarësisë dhe të ç'regjistrohet nga anëtarësia në Parti.

Neni 14. –

Propozimi për përjashtim nga Partia iniciohet nga nëndega, ndërsa vendimin e merr kryesia e degës.

Paraprakisht, anëtarit të Partisë i mundësohet që të arsyetojë qëndrimin e tij dhe të parashtroj prova në mbrojtjen e tij.

Kundër vendimit për përjashtim mund të parashtrohet ankesë Komisionit disiplinor në afat prej 15 ditësh.

Vendimi i Komisionit disiplinor është definitiv.

Neni 15. –

Kërkesa për rianëtarësim i parashtrohet kryesisë së nëndegës ku e ka vendbanimin të përhershëm anëtari i partisë.

Lidhur me kërkesën, paraprakisht i merret pëlqimi nga organi që e ka iniciuar procedurën për përjashtimin nga Partia.

III TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE

Neni 16.

Të drejtat e anëtarëve të LD-së, janë:

- pjesëmarrja aktive në realizimin e politikave partiake,
- të zgjidhet dhe të jetë i zgjedhur në organet e Partisë dhe në listat zgjedhore parlamentare apo komunale,
- të informohet mbi gjendjen dhe aktivitetet e Partisë dhe organeve të Partisë,
- të inicioj propozime dhe të shprehë mendimin lidhur me aktivitetet e Partisë dhe aktualitetet në shoqëri që kërkojnë angazhim të Partisë,

Neni 17.

Detyrat e anëtarit të LD-së, janë:

- të veprojnë në harmoni me programin, statutin dhe aktet tjera të Partisë,
- nuk ka të drejtë pjesëmarrjeje në manifestime që bien në kundërshtim me qëndrimin politik të Partisë,
- nuk ka të drejtë të angazhohet në ndonjë organizatë apo shoqatë, për të cilën organet kompetente të partisë vlerësojnë se vepron kundër LD-së,
- të angazhohet aktivisht në realizimin e orientimeve programore të Partisë,
- në institucionet e sistemit politik në mënyrë dinjitoze të përfaqësojë orientimet programore të Partisë dhe qëndrimet e organeve Partiake,
- të paguajë anëtarësinë,
- të zbatojë vendimet e organeve të Partisë,
- të ruaj dhe të avancoj autoritetin dhe prestigjin e Partisë.

Detyrat e anëtarëve të Partisë përcaktohen me Rregullore të veçantë.

Lëvizja ka Zyrtarin Financiar, të cilin e emëron Kryetari dhe i përgjigjet drejtpërsëdrejti atij.

Zyrtari Financiar është përgjegjës për:

- Përgatitjen dhe ekzekutimin e planeve financiare (buxhetit);
 - Hartimin e raporteve financiare dhe raportimin para institucioneve të parapara me ligj.
- Këshilli i Përgjithshëm i Lëvizjes, me propozim të Kryesisë, cakton lartësinë e pagesës së anëtarësisë për çdo vit kalendarik, si dhe destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Kryesia e Lëvizjes, çdo vit, cakton shumën e mjeteve të cilat u barten degëve, sipas kritereve të cilat rregullohen me rregullore të veçantë.
- Për mjetet financiare të Lëvizjes dhe shfrytëzimin e tyre, Kryesia i raporton Këshillit të Përgjithshëm çdo vit.

IV ORGANIZIMI I PARTISË

ORGANET DREJTUESE

Neni 18.

Organet e Partisë janë:

- Kuvendi,
- Këshilli Drejtues,
- Kryetari,
- Kryesia e Partisë,
- Komisioni Disiplinor,
- Organet tjera në strukturat e LD-së.

KUVENDI

Neni 19.

Kuvendi është organi më i lartë i Partisë.

Delegatët e Kuvendit zgjedhën nga radhët e anëtarësisë nëpër degët e Partisë dhe nga anëtarësia në diasporë.

Një numër i delegateve zgjedhën nga kuvendi, një numër i delegateve janë sipas pozitës, një numër i delegateve zgjedhën nga Kryesia me propozim të kryetarit të Partisë.

Sipas pozitës, delegatët e Kuvendit janë: Kryetari i Partisë, anëtarët e Këshillit Drejtues, Kryesia e Partisë dhe kryetari i Komisionit Disiplinor me mandat aktiv.

Numrin, mënyrën dhe kriteret e delegimit të delegatëve të Kuvendit përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues të Partisë.

Kryesia e Partisë me propozim të Kryetarit të Partisë emëron 5% të delegatëve nga numri i përgjithshëm i delegatëve të deleguar për Kuvend të cilët zgjedhën me përfaqësim proporcional nga gjithë anëtarësia, në bazë të kriterit territorial, profesional, gjinor dhe të moshës me qëllim të funksionimit sa më të mirë të Partisë.

Mandati i delegatëve zgjat _____ vjet.

Neni 20.

Kuvendi i partisë:

- miraton Programin e Partisë,
- miraton Statutin e Partisë,
- shqyrton dhe vlerëson performancën e përfaqësuesve të saj në organe, legislative dhe ekzekutive ndërmjet dy Kuvendeve,
- zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Partisë dhe nënkryetarët e Partisë,
- zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues,
- zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komisionit Disiplinor,
- nxjerr akte të përgjithshme normative.

Neni 21.

Programi dhe Statuti i Partisë si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve pjesëmarrës në Kuvend.

Kuvendi zgjedhor i degës mbledhet çdo dy (2) vite. Kuvendi mbledhet çdo vit, në mbledhje të rregullt për shqyrtimin e punës njëvjeçare të degës. Sipas nevojës mund të thirret edhe Kuvendi i jashtëzakonshëm, me vendim të Kryesisë së Lëvizjes, ose Kryesisë së degës.

Numri i anëtarëve të Kuvendit të degës nuk mund të jetë më i vogël se pesëdhjetë anëtarë.

Me rastin e përcaktimit të listës së anëtarëve të Kuvendit të degës, çdo nëndegë duhet të sigurojë që 30% e anëtarëve të jenë femra.

Kuvendi i degës mund ta fillojë mbledhjen pas vërtetimit të kuorunit që e paraqet shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes duhet të aprovohet rendi i ditës me 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm, me mandat të verifikuar.

Vendimet e Kuvendit të degës janë të vlefshme kur për to votojnë me shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Puna e Kuvendit të degës përcaktohet me këtë Statut dhe Rregulloren e punës.

Neni 22.

Kuvendi zgjedh Kryetarin e Partisë me më shumë kandidat të propozuar.

Kryetari i Partisë propozon kandidatët për nënkryetar dhe sekretarin e përgjithshëm të Partisë nga anëtarët e Këshillit Drejtues. Me propozimin e Kryetarit të Partisë, Këshilli Drejtuesi zgjedh pesë nënkryetar. Kandidatët e zgjedhur janë kandidatë me më shumë vota nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Neni 23.

Kuvendi është i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.

Kuvendi i rregullt mbahet çdo katër vjet, kurse sipas nevojës mund të thirret edhe më herët (Kuvendi i jashtëzakonshëm).

Vendimin për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm e miraton Këshilli Drejtues.

Iniciativën për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm mund të paraqesin 1/3 e anëtareve të Këshillit Drejtues ose 1/3 e degëve të Partisë që kanë garuar në zgjedhjet e fundit komunale.

Në raste kur iniciohet procedura e përgjegjësisë ose shkarkimit të Kryetarit ose të një ose më shumë nënkryetarëve të Partisë, Këshilli Drejtues me 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i Këshillit Drejtues mund të merr vendim për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm.

Vendin dhe datën e mbajtjes së Kuvendit e cakton Këshilli Drejtues. Për datën e mbajtjes së Kuvendit delegatët informohen 30 ditë më herët. Përveç ftesës delegatët marrin edhe propozimin për rendin e ditës dhe materialin e Kuvendit në formë të shkruar.

Vendimet e kuvendit janë të formës së prerë.

KËSHILLI DREJTUES

Neni 24.

Këshilli Drejtues është organi më i lartë politik i Partisë ndërmjet dy Kuvendeve.

Këshilli Drejtues numëron gjithsejtë 1/3 e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 25.

Këshilli Drejtues nga radhët e veta zgjedh Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, dhe 5 (pesë) nënkryetar.

Kryetari organizon dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit Drejtues.

Kryetari dhe nënkryetarët e Partisë bëjnë implementimin e vendimeve të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues i Partisë formon komisionet e saja. Anëtarët e Komisionit janë anëtar të Këshillit Drejtues. Llojet e komisioneve, kompetencat dhe mënyrën e të vepruarit e përcakton Këshilli Drejtues.

Neni 26.

Këshilli Drejtues mbahet së paku një herë në tre muaj dhe sipas nevojës.

Këshilli Drejtues duhet doemos të caktoj mbledhjen kur kërkohet mbajtja e mbledhjes nga Kryesia e Partisë, më së paku 2/3 e anëtarëve të saj ose me kërkesë të Kryetarit të Partisë.

Neni 27.

Kuvendi i Partisë nga delegatët zgjedh 1/3 e tyre për anëtar të Këshillit Drejtues.

Kandidimi dhe zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet në mënyrë që të sigurohet respektimi proporcional i përfaqësimit nga degët në vend dhe diasporë, numri i votave të fituara në zgjedhjet e fundit, duke respektuar kriterin gjinor dhe moshën.

Neni 28.

Ndërmjet dy Kuvendeve, Këshilli Drejtues ka të drejtë në kooptimin e numrit të caktuar të anëtarëve me qëllim të plotësimit të vendeve të lira.

Kooptimi bëhet nga lista e cila është votuar në Kuvend në pajtim me alinenë 2 të nenit 27.

Neni 29.

Këshilli Drejtues shqyrton dhe vendos, nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

Vendimet merren me votimin e më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm.

Neni 30.

Pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit Drejtues në mbledhje është e obligueshme. Mospjesëmarrja e paarsyeshme në tre mbledhje radhazi, rezulton me pezullim të mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues, i cili pozicion plotësohet në Kuvendin e radhës.

Neni 31.

Këshilli Drejtues:

propozon dhe sugjeron Programin dhe Statutin e Partisë,

- miraton Rregulloren e punës dhe akte tjera normative,
- zgjedh Sekretarin e përgjithshëm dhe anëtarët e Kryesisë,
- zgjedh komisionet, këshillë dhe trupat punuese nga lëmenjtë të ndryshëm,
- miraton llogarinë përfundimtare dhe buxhetin për vitin vijues,
- miraton programin dhe platformën zgjedhore,
- zgjedh shtabin qendror zgjedhor të Partisë,
- miraton listën e kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme dhe komunale,
- themelon degë të reja apo i shuan ato po që se nuk i përmbahen Programit, Statutit apo Rregulloreve të Partisë,
- vendos për koalicione para dhe pas zgjedhjeve.

KRYETARI I PARTISE

Neni 32.

Kryetari i Partisë:

- përfaqëson Partinë në vend dhe jashtë vendit,
- udhëheq punën e organeve të Partisë,
- bën koordinimin e organeve të Partisë dhe përkujdeset për implementimin e vendimeve të tyre,
- bën hapjen e Kuvendit
- thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë dhe të Këshillit Drejtues,
- propozon nënkryetarët dhe sekretarin e Partisë,
- propozon komisione dhe trupa punuese në lëmi të ndryshëm,
- propozon përbërjen e delegacioneve të Partisë për takime brenda dhe jashtë vendit.
- Propozon përjashtimin e anëtarit që bënë shkelje të rëndë disiplinore.
- Koopton individ të caktuar në struktura udhëheqëse të Partisë.

Neni 33.

Për punën e vet Kryetari i përgjigjet Kongresit, Këshillit Drejtues dhe Kryesisë së Lëvizjes.

Mandati i Kryetarit të lëvizjes zgjat 4/katër/ vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Në rast të dëmtimit të imazhit dhe prestigjit të Lëvizjes, rrezikimit të interesave të Lëvizjes dhe keqpërdorimit të postit, Kryetari mund të shkarkohet edhe para mandatit.

Vendimi për thirrjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm duhet të merret nga Këshilli Drejtues, me 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij. Propozimin për të marrë një vendim të tillë në Këshillin Drejtues mund ta bëjë Kryesia e Lëvizjes, kur për këtë kanë votuar 3/4 e anëtarëve të saj. Vetë Kryesia mund të marrë në shqyrtim këtë çështje kur këtë e kërkon shumica e thjeshtë e anëtarëve të saj, ose kur kërkesa mbështetet nga më shumë se gjysma e degëve të PD-së.

Neni 34.

Partia e ka nënkryetarin e Partisë.

Partia ka gjithsejtë 5/pesë/nënkryetar.

Nënkryetari i Partisë zëvendëson Kryetarin e Partisë në raste kur kryetari për çfarëdo arsye nuk ka mundësi të ushtroj funksionin e tij. Me këtë rast e bënë bartjen e autorizimit në njërin nga nënkryetarët apo te Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 35.

Sekretari i përgjithshëm i Partisë ndihmon kryetarin e Partisë, nënkryetarët e Partisë, anëtarët e Këshillit Drejtues në organizimin dhe koordinimin e punëve të tyre dhe përkujdeset për funksionimin organizativ të Partisë.

KRYESIA E PARTISË**Neni 36.**

Organi ekzekutiv politik i Partisë është Kryesia e Partisë që numëron 21/njëzetënjë/anëtar.

Për nga pozita Kryesia përbëhet nga kryetari, nënkryetarët, sekretari, kryetarja e Vizionit të Gruas dhe kryetari i Vizionit Rinor.

Anëtarët të tjerë i zgjedh Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues zgjedh 2/3 e anëtarëve të Kryesisë kurse 1/3 tjetër në propozim të kryetarit, Këshilli Drejtues voton për ose kundër listës së propozuar nga Kryetari.

Kryesia e Partisë medoemos në përbërjen e saj duhet të respektoj përfaqësimin territorial, gjininë dhe moshën.

Neni 37.

Kryesia e Partisë:

- ekzekuton vendimet dhe qëndrimet e Kuvendit të Partisë,
- udhëheq aktivitete politike në bazë të programit të Partisë,

- në pajtim me Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Partisë disponon dhe përkujdeset për pasurinë e Partisë,
- shqyrton dhe miraton planin dhe raportin vjetor të punës,
- shqyrton dhe miraton raportin financiar të Partisë,
- nxjerr Rregullore mbi organizimin e Shërbimeve profesionale të Partisë,
- ka edhe kompetenca tjera të përcaktuara me Statut.

Neni 38.

Mandati i anëtarëve të Kryesisë zgjat 4/katër/vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

NËNKRYETARËT E PARTISË

Neni 39.

Partia ka 5/pesë/nënkryetar.

SHËRBIMET PROFESIONALE TË PARTISË

Neni 41.

Me qëllim të analizimit të çështjeve të caktuara dhe përgatitjes të elaborateve, Kryesia e Partisë themelon Komisione Profesionale.

Komisionet Profesionale formohen nga anëtarët e Kryesisë së Partisë, Këshillit Drejtues të Partisë, ku në përbërje të tyre mund të hyjnë edhe anëtar të tjerë të Partisë.

Sipas nevojës Kryesia e Partisë mund të formoj edhe disa Komisione Profesionale me përbërje nga 3 deri 5 anëtar.

Me Komisionet Profesionale udhëheq sekretari i Partisë, i cili organizon dhe koordinon punën e tyre si tërësi dhe përgjigjet për punën e tyre.

KOMISIONI DISIPLINOR

Neni 42.

Komisioni Disiplinor vendos mbi shkeljet e lehta dhe të rënda disiplinore të anëtarëve.

Komisioni Disiplinor i Apelit është i obliguar të vendos për ankesat në afat prej 30 ditësh.

Komisioni Disiplinor i Apelit në rast kontesti, interpreton Statutin e Partisë.

Komisioni Disiplinor dhe Komisioni Disiplinor i Apelit përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe 3 anëtarë.

ORGANIZIMI TERRITORIAL I PARTISE

Neni 45.

Në aspektin territorial, Partia është e organizuar në: aktive-vendvotime, nëndegë-qendra të votimeve, degë, këshillë regjionale dhe organe qendrore.

Neni 46.

Aktivi-vendvotimi është njësi më e vogël e organizimit territorial të Partisë.

Aktivi-vendvotimi organizon aktivitet politik në një territor që banorët e tij votojnë në një pikë votimi. Koordinatorin e aktivitet-vendvotimit cakton nëndega-qendra e votimit.

Neni 47.

Nëndega-qendra e votimit është njësi e organizimit territorial e Partisë, e cila formohet konform numrit të qendrave të vendvotimeve në komunë.

Nëndegën-qendrën e votimit e themelon kryesia e degës së Partisë.

Organet drejtuese të nëndegës-qendrës së votimit janë:

- a) Kuvendi
- b) Kryesia – e zgjedhur nga Kuvendi e cila numëron 7-11 anëtarë,
- c) Kryetari – të cilin e zgjedh Kryesia e nëndegës-qendrës së votimit.

Kuvendi i nëndegës-qendrës së votimit ka mandat katër vjeçar.

Kryesia e nëndegës-qendrës së votimit mbledhet së paku një herë në muaj.

Në mbledhjet e Kryesisë së nëndegës-qendrës së votimit kanë të drejtë të marrin pjesë anëtarët e Kryesisë së Degës, por pa të drejtë vote.

Mbledhjet e Kryesisë së nëndegës-qendrës së votimit i drejton kryetari i nëndegës-qendrës së votimit apo personat e autorizuar nga kryetari (nënkryetari apo anëtari i kryesisë).

Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të Kryesisë ku Kryetari ka votë me vlerë të dyfishtë.

-

-

Neni 48.

Dega e Partisë është njësi kryesore organizative e Partisë, e cila sipas rregullës përfshin territorin e dy ose me shume nëndegëve në një vend të caktuar.

Në qendrat e mëdha urbane dhe me specifika të veçanta mund të themelohen më shumë se një degë.

Themelimin e degës e bënë Këshilli Drejtues.

Organet drejtuese të degës janë :

- a) Kuvendi,
- b) Këshilli i Degës,
- c) Kryesia,
- d) Kryetari.

Kuvendi zgjedhor i degës mbledhet çdo katër vjet. Për shqyrtimin e punës njëvjeçare të degës, Kuvendi mbledhet çdo vit ne mbledhje të rregullta.

Numri i anëtarëve të Kuvendit të degës përcaktohet nga Këshilli i Degës.

Me rastin e delegimit të anëtarëve në Kuvendin e Degës duhet të respektohet kriteri territorial, gjinisë dhe i mosha.

Këshilli i Degës është organi më i lartë politik i degës së Partisë.

Këshilli i degës zgjidhet duke u respektuar kriteri territorial, gjinisë dhe moshës.

Këshilli i degës numëron _____ anëtarë. Anëtarët e Këshillit të degës janë anëtarët e Kryesisë së degës, kryetarët-koordinatorët e nëndegëve-qendrave të votimit dhe koordinatorët e aktiveve-vendvotimeve.

Këshilli i Degës e zgjedh Kryetarin dhe Kryesinë e degës e cila numëron _____ anëtarë. Me propozimin e Kryetarit zgjedhen tre nënkryetarët, sekretari dhe 1/3 e kryesisë së degës së Partisë. Pjesën tjetër të Kryesisë e zgjedhë Këshilli i Degës nga rrallët e Këshillit të Degës. Kryesia e degës zgjedhet duke u respektuar kriteri territorial, gjinor dhe ai i moshës.

VI FUNKSIONIMI I PARTISE

Neni 49.

Vendimet në Parti merren me konsensus ose me votim.

Vendimi merret pas debatit dhe shkëmbimit të lirë të mendimeve. Vendimi i aprovuar me shumicë votash është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët dhe organet e Partisë.

Vendimi i strukturave më të ulëta të Partisë nuk mund të anulohet nga strukturat me të larta, përveç në raste kur vlerësohet se është në kundërshtim me Programin dhe Statutin e Partisë.

Neni 50.

Kandidatet për zgjedhje komunale i propozon Këshilli Drejtues i Degës, ndërsa vendimin për përcaktimin e listës e merr Këshilli Drejtues i Partisë.

Kandidatët për zgjedhje nacionale propozohen nga Kryetari dhe Kryesia në bashkëpunim me Degët.

Listën përfundimtare për kandidat në Zgjedhje Nacionale, pas një debati, e miraton Këshilli Drejtues i Partisë.

Neni 51.

Partia zhvillon politikën e saj në institucione shtetërore nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në këto organe.

Deputetet e Partisë, të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës, përbëjnë Grupin Parlamentar të Partisë.

Grupi i deputeteve të Partisë është strukturë politike e Partisë.

Grupi Parlamentar paraprakisht diskuton për çështjet që do të shqyrtohen dhe e mbron në Kuvend qëndrimin e Partisë.

Hapësirën e veprimit të anëtarëve të vet për votim në seancën parlamentare, Grupi Parlamentar e vendos paraprakisht, sipas rëndësisë dhe natyrës së çështjes që shqyrtohet.

Vendimi politik i aprovuar me shumicë të votave është i detyrueshëm për anëtarët e Grupit Parlamentar.

Mënyra e organizimit dhe e veprimit të GP përcaktohet me Rregullore të veçantë të Këshillit Drejtues.

Deputeti i Partisë përmbushë të gjitha detyrimet dhe kërkesat e Rregullores së brendshme të GP.

Neni 52

Për Këshilltarët Komunal vlejné të gjitha rregullat që vlejné për Grupin Parlamentar.

VII ZGJEDHJET NË PARTI

Neni 53.

Zgjedhjet në Parti mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Zgjedhjet e rregullta në organet e Partisë mbahen në çdo katër vjet.

Para mbajtjes së Kuvendit të rregullt mbahen zgjedhjet në të gjitha organet e të gjitha niveleve, që nga aktivet deri te organet më të larta.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme mbahen nëse kushtet dhe rrethanat të krijuara në Parti imponojnë një gjë të tillë.

Mbajtja e Kuvendit të jashtëzakonshëm në Parti nënkupton mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Parti.

Neni 54.

Zgjedhjet për organe dhe poste në Parti bëhen me votim të fshehtë me më shumë kandidate ose duke votuar për listat në tërësi me PER ose KUNDER LISTES, siç është e përcaktuar me Statut.

Procedurat zgjedhore në Parti i përcakton Këshilli Drejtues.

Neni 55.

Të gjithë kandidatet për poste dhe organe partiake duhet të gëzojnë autoritet në vendin ku jetojnë, punojnë dhe të tregojnë lojalitet për orientimet Programore dhe synimet e Partisë.

VIII SHKARKIMI

Neni 56.

Të gjithë anëtarët e Partisë të zgjedhur në poste kanë përgjegjësi për punën e tyre. Ata për mospunën dhe papërgjegjësinë mund të shkarkohen.

Shkarkimi bëhet me procedurë të njëjtë si zgjedhja.

Në raste kur organi, bartësi i postit apo anëtari i ndonjë organi të Partisë ka humbur besimin e bazës deleguese, mund të iniciohet procedura e votëbesimit.

Kërkesa për shkarkim duhet të argumentohet.

Propozimin për shkarkim e inicion Kryetari, ndërkaq vendimin e merr organi i cili e ka zgjedhur, nëse për të votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm të atij organi.

IX ÇËSHTJET FINANCIARE

Neni 57.

Partia realizon të hyra nga:

- anëtarësia,
- të ardhurat buxhetore,
- organizimi i aktiviteteve të ndryshme,
- donacionet vullnetare të personave juridik dhe fizik dhe
- në mënyra të tjera legale konform Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.
- çështjet financiare të partisë përcaktohen me Rregulloretë veqantë.

Neni 58.

Në rast të shuarjes së Lëvizjes, përgjegjësinë për borxhet dhe pasurine e Lëvizjes e marrin themeluesit e Lëvizjes. Pasuria materiale e sajë dedikohet për nevoja bëmirësie.

Lëvizja mund të pushojë së ekzistuari nëse për këtë vendosin $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e të gjithë delegatëve në mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të Lëvizjes.

Në rast të shpërbërjes së Lëvizjes, së pari përmbushen të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve, kurse pjesa e mjeteve të mbetura, me vendim të posaçëm të organit që merr vendim mbi shpërbërjen e Lëvizjes, do të shpërndahen në organizata humanitare të vendit.

X R A P O R T I M I

Neni 59.

Anëtarët e Kryesisë të të gjitha niveleve në çdo tre muaj për aktivitete e tyre raportojnë Kryesinë përkatëse.

Raporti i deponuar me shkrim përfshinë aktivitetin, numrin e anëtarëve, situatën politike dhe ekonomike, etj.

Neni 60.

Për aktivitetet e kryera, Kryesia e Partisë, çdo tre muaj, paraqet raport me shkrim Këshillit Drejtues.

Neni 61.

Organet më të ulëta të partisë kanë të drejtë të informohen për punën, aktivitetet , gjendjen politike dhe financiare të organeve më të larta dhe të njëjtit janë të obliguar të informojnë.

DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 62

Ky Projekt-Statut hynë në fuqi me miratimin në Kuvendin Themelues të Lëvizja për Drejtësi të Kosovës.

Me, 00.00.2017

Prishtine

Kryetari i Këshillit Nismëtar,

Sylejman Cerkezi

-